

V E N D I M
Nr.344, datë 9.7.1993

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.345, DATË
10.8.1992 "PËR SHPËRBLIMIN E PUNËS SË PUNONJËSVE"**

Në zbatim të dekretit nr.596, datë 8.7.1993 "Për një ndryshim në ligjin nr.7583, datë 13.7.1992 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.345, datë 10.8.1992, ndryshuar me vendimin nr.203, datë 4.5.1993, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 10, paragrafi i tretë dhe i katërt ndryshohen si vijon:

- Nëse ndërmarrja shtetërore, institucioni shtetëror jobuxhetor dhe pjesërisht jobuxhetor rritin pagën mesatare mujore mbi 5 deri 30 për qind mbi masën e rritjes në përqindje të miratuar nga Këshilli i Ministrave, nuk zbatohet asnjë sanksion, vetëm për rastet kur plotësohen edhe këto kriteret financiare: nuk kanë detyrime tatimore ndaj buxhetit të shtetit, ndaj kredive dhe interesave bankare, ndaj kontributit të sigurimeve shoqërore, përkrahjes sociale dhe detyrimeve për energjinë elektrike të papaguara në afat, përndryshe atyre nuk u lind e drejta e rritjes së pagës mesatare.

- Nëse ndërmarrja shtetërore, institucioni shtetëror jobuxhetor dhe pjesërisht jobuxhetor rritin pagën mesatare mujore mbi 30 për qind mbi masën e miratuar në përqindje nga Këshilli i Ministrave, edhe kur plotësohen kriteret financiare të përcaktuara në paragrafin e mësipërm, detyrohen të derdhin në buxhetin e shtetit një pjesë të fitimit, baraz me 500 për qind të kësaj rritjeje".

b) Në fund të pikës 11 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Ndërmarrjet që subvencionohen nga shteti për çdo rast rritjen e pagës mesatare do ta përballojnë brenda masës së subvencionit të miratuar".

c) Në pikë 13, paragrafi i katërt ndryshohet si vijon:

"Shtesat mbi pagë të dhëna për punën e realizuar në mbikohë, në ditët e pushimit, në ditët e diela, festat zyrtare, në ndërresën e dytë e të tretë".

2. Kriteret e përcaktuara në pikën 1, shkronja "a" e këtij vendimi, zbatohen për detyrimet që lindin nga veprimtaria financiare e ndërmarrjes pas datës 1 korrik 1993.

3. Kriteret e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.203, datë 4.5.1993, pika 1, shkronja "a", paragrafi i tretë, zbatohen për detyrimet që lindin nga veprimtaria financiare e ndërmarrjes pas datës 4.5.1993, kurse kriteri i rentabilitetit nuk zbatohet që nga kjo datë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij nga data 1 korrik 1993.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi